



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Datë /a/e:	21.02.2020
Referencë:	07-353/04-37358/20
Për / Za/ To:	Kolegji Haimerer- Prishtinë
Nga/ Od/ From:	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Kontrolloi:	Habib Qorri
Punoi:	Sabri Gashi
Tema/ Subjekat/Subject:	<b>Pëlqim</b>

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit përmes QSHQ, ka pranuar kërkesën e Kolegjit Haimerer nga Prishtina, për shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin "Zahir Pajaziti". Qëllimi i kërkesës ka të bëjë me organizimin e aktivitetit –Dita Evropiane e Logopedisë Drejtoria pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, nën shkronja g), i) të Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike, nr.01-110-157481, i jep

### Pëlqimin

**Kolegji Haimerer** për shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin „Zahir Pajaziti” para Hotel Grandit .

Shfrytëzimi i hapësirës ka të bëjë me organizimin e aktivitetit „Java e Logopedisë duke improvizuar një kabinet logopedik për Disleksin që nënkupton çrregullime në të shkruar dhe lexuar ku të gjithë të interesuarit mund të konsultohen dhe këshillohen nga ekspertet e Kolegjit Organizimi i aktivitetit mbahet 06.03.2020 nga ora 10:00-15:00 në baze të axhendes së organizatorit.

Për mbajtjen e aktivitetit nevojitet një hapësirë 5.00x5.00m .

Organizatori obligohet që:

- të mos paraqesin pengesë për lëvizjen e lirë të këmbësorëve;
  - të kujdesen mirë për pjesëmarrësit gjatë aktivitetit dhe të bashkëpunoj me Policinë e Kosovës për sigurimin e aktivitetit .
  - Te mos shpërndaj broshura qe hedhen dhe krijojnë mbeturina .
  - pas përfundimit të aktivitetit, hapësira të jetë e lirë si në gjendjen e mëparshme.
- Po ashtu, nëse kërkohet ndonjë urgjencë nga Komuna, hapësira duhet të lirohet në afat kohor të cilin e kërkon Komuna.